



31 Gusht 2023

Nr. Prot 77

Drejtuar: Znj. Delina Ibrahimaj
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë

Objekti: Komentet e biznesit mbi Projektligjin “Për Taksën mbi pasurinë e paluajtshme”

Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri (në vijim referuar si “Dhoma”) në funksion të misionit të saj për të ndihmuar bizneset të punojnë në një klimë të qëndrueshme, e konsideron me rëndësi të madhe miratimin e projektligjit “Për Taksën mbi pasurinë e paluajtshme”, projektligj i cili sjell nje reformim rrënjësor të sistemit të taksimit të pasurive të paluajtshme në Shqipëri.

Dhoma ka ndjekur me mjaft interes çdo diskutim për këtë projektligj duke qënë mjaft aktive në mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve nga anëtarët e saj për të kontribuar që ky ligj të jetë sa më i qartë, sa më i drejtë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Me anë të kësaj shkrese Dhoma synon të përcjellë komentet e anëtarëve të saj në lidhje me këtë Projektligj, të cilat janë si më poshtë:

Konstatojmë se ky projektligj ka probleme thelbësore në konceptim dhe në shkrim. Problemet i vërejmë në formulimin e disa përkufizimeve të cilat janë të paqarta, evazive, pa referenca të sakta dhe në disa raste të pasakta por edhe në **mbivendosjen apo përplasjen e dispozitave me ligje të tjera**.

Ky është një ligj kompleks i cili rikonceptualizon taksën mbi pasurinë e paluajtshme duke sjellë një reformë strukturore ashtu sic parashtrohet gjatë gjithë relacionit që shoqëron projektaktin. Sic përmendet në relacion, projektakti i publikuar, ka rezultuar pas një projekti disavjecar si dhe duke marrë në konsideratë rekomandime të disa organizatave/institucioneve ndërkombëtare. Në këtë kuadër, mendojmë që projektakti mund të jetë i kuptueshëm nga ekspertët e fushës, teknikë dhe juristë por ka vështirësi për t’u kuptuar nga publiku në tërësi. Gjithashtu konstatojmë se për këtë projektligj procesi i konsultimit publik nuk është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi (afati, mënyrat e njoftimit si dhe takimet e zhvilluara me grupet e interesit).

Duke qënë se ndryshimet thelbësore të ligjit do të fillojnë të aplikohen vetëm duke filluar nga 1 janar 2026 për ndërtesat dhe 1 janar 2028 për tokën/truallin, nuk e kuptojmë cili është qëllimi pas miratimit të këtij ligji që në vitin 2023 dhe më emergjence, pa u konsultuar për një periudhë të arsyeshme.





Për më tepër që procesi i konsultimit limitohet vetëm në publikimin e draftit në internet dhe pritjen e komenteve me shkrim nga përfaqësuesit e biznesit. Akte të rëndësishme si ky, por edhe vitin e kaluar ligji për tatimin mbi të ardhurat, nxirren për konsultim publik në periudhë pushimesh verore kur bizneset janë duke punuar me staf të reduktuar. Sado të aftë dhe largpamës të jenë bizneset, mungesa e takimit fizik dhe dialogut verbal, si dhe koha e pushimeve kur akti del për konsultim, lë shteg për moskuptime dhe paqartësi, të cilat cojnë pastaj në ndërhyrjet ligjore të qeverisë në projektakt që para sesa akti vetë të zbatohet për herë të parë.

Gjithsesi më poshtë gjeni komentet tona paraprake.

1. Përcaktimi i metodologjise së vlerësimit duhet të bëhet nga ligji dhe jo të lihet në dorë të qeverisë.

Neni 118 i Kushtetutes përcakton se “Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. **Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte**”.

Duke qenë ky projektligj sjell risi në procesin e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, metodologjia në këtë proces vlerësimi është thelbi dhe ka impakt te menjëhershëm dhe interes më të lartë tek publiku. Pavarësisht se kjo metodologji pritet të zbërthehet në një VKM, në çdo rast, për qëllim të reformës strukturore që ky projektligj pritet të sjellë, si dhe kuptueshmërinë e tij në shkallë të gjerë nga publiku si dhe në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është shumë e rëndësishme që ligji vetë të përcaktojë parimet bazë të metodologjisë së vlerësimit pa e lënë këtë në diskrecion të plotë të Këshillit të Ministrave.

Procesi i vlerësimit është momenti më i prekshëm dhe më me interes i këtij projektligji. Nëse ligji përcakton vetëm tarifën e taksës dhe ndërkohë qeveria është e lirë të përcaktojë mënyrën/metodologjinë e vlerësimit të bazës së tatueshme, jemi në kundërshtim me parimin kushtetues që taksat vendosen me LIGJ. Taksa quhet e vendosur nëse përcaktohet tarifa dhe vlera e tatueshme. Përndryshe, nëse vlera e tatueshme mungon, atëherë ligji nuk ka arritur të vendosë taksën por ia ka lënë në diskrecion qeverisë. Për më tepër, nga pikëpamja praktike, projektakti duhet të shoqërohet me ilustrime të përllogaritjeve dhe shembujt e ofruara në relacion nuk janë të mjaftueshme.

Gjithashtu, konstatojmë se tarifatat e reja janë shumë të larta krahasuar me ato ekzistuese. Në relacion flitet për rritje të të ardhurave nga taksa e pasurisë por rritja duhet të vijë nga mirëadministrimi dhe jo nga katërfishimi i normës tatimore.

Fleksibiliteti që kanë bashkitë për dyfishimin e normës nga vlera minimale tek ajo maksimale lë shkak për abuzim, duke patur parasysh dhe njohuritë e limituara që kanë treguar bashkitë deri tani në vendosjen dhe mbledhjen e taksave, përfshirë imagjinatën e tyre në disa raste në vendosjen e taksave të targetuara drejt një subjekti privat të caktuar (ndonjëherë edhe me emër specifik në një vendim këshilli bashkiak) vetëm me qëllim mjeljen e atij biznesi tej logjikës ekonomike dhe mbushjen e buxhetit të bashkisë.

Këmbëngulim që të ketë vetëm një normë tatimore për taksën e pasurisë dhe bashkia të ketë të drejtë ta ulë, nëse vendos kështu.

Nëse bëjmë një krahasim të normave tatimore mes pronave të ndryshme vëme re se gati barazohet banesa/shtepia me një dyqan/qendër tregtare. Prona rezidenciale tatohet deri në





0.2% ndërsa prona tregtare vetëm 0.25 përqind. Duhet theksuar se prona tregtare nxjerr të ardhura dhe nga ato mund të alokohen disa për të rritur taksën e pronës, por shtëpia nuk nxjerr të ardhura, përkundrazi krijon shpenzime dhe afrimi i normës tatimore nuk përbën një taksim të drejtë. Për më tepër, tatóhen po me normë 0.25% edhe ndërtesa që janë kategori prone industriale. Si mund të barazohet një qendër tregtare me një kápanon prodhimi? A duam të tatójme më shumë industrinë dhe prodhimin?

2. Mbështetja dhe referenca në ligje të tjerë.

Projektligji është hartuar pa marrë në konsideratë legjislacionin ekzistues në Shqipëri qoftë ligjin për procedurat tatimore, qoftë Kodin e Procedurave Administrative apo ligje të tjerë.

Projektligji jep disa përkufizime të koncepteve të zhvilluara në ligje të tjerë. Një ligj i hartuar mirë harmonizohet me legjislacionin ekzistues, përndryshe do të kemi përkufizime të të njëjtit term të cilët janë të ndryshëm në ligje të ndryshme.

Sugjerojmë që aty ku është e mundur të ketë referenca në akte të tjera ligjore që sqarojnë terma, koncepte dhe situata ligjore, me qëllim kuptueshmërinë si dhe duke mos lënë hapësira për interpretim jo të duhur.

Për më tepër, edhe ligji për procedurat tatimore u hartua me ndihmën e konsulentëve të huaj dhe është një ligj që ka krijuar një praktikë të konsoliduar.

Nuk ka asnjë arsye pse vendosja e gjobave, kamatave, procedura e apelimit, masat shtrënguese apo të ngjashme të mos aplikohen sic janë tek procedurat tatimore, për taksat vendore. Për më tepër, qëllimi i ligjit për procedurat tatimore ka qenë që të jetë një ligj procedural gjithëpërfshirës. Projektligji krijon procedura të reja pa argumentuar arsyen e këtij ndryshimi themelor.

3. Përcaktimi dhe ndarja e kompetencave të bashkisë/këshillit bashkiak

Sugjerojmë që projektligji duhet të përcaktojë qartazi kompetencat dhe tagrat e Bashkisë si dhe Këshillit Bashkiak, në lidhje me administrimin, në përcaktimin e shkallës së taksës dhe ekzekutimin.

Problematikat ligjore ekzistuese lidhur me pronat e paluajtshme në vendin tonë, mungesa e një baze të saktë të të dhënave për taksën e pasurisë së paluajtshme si dhe përcaktimi dhe zbatimi i metodologjisë efektive janë sfidat kryesore për suksesin e këtij projektligji.

Gjithashtu vërejmë se e gjithë procedura e vetëdeklarimit apo e verifikimit/inspektimit të pasurive të paluajtshme që nuk janë të regjistruara në Kadastër është konfuze dhe e paqartë.

Nuk del e qartë nga projektligji nëse pronat e paluajtshme të papërfunduara/ pakolauduara/ të paregjistruara do të paguajnë taksën dhe mbi bazën e cilit dokumentacion? Si do të kryhet përlllogaritja e taksës dhe mbi bazën e cilave kritere do të vlerësohet baza e taksueshme?

Nuk është e qartë nga projektligji se përgjegjësi e kujt është përgatitja dhe lëshimi i faturës, mbledhja e taksës (Pushteti lokal, organ shtetëror, subjekt privat etj)





Është pa sens ekzistenca e dy regjistrave në lidhje me të njëjtat të dhëna. Konkretisht Kadastra Fiskale publikon regjistrin Kadastral. ASHK ka të gjitha (ose mund të ketë në cdo rast) të dhenat e nevojshme në lidhje me përllogaritjen e taksës së pronës.

Si më poshtë do të gjeni një përmbledhje të detajuar të neneve përkatëse për të cilat rekomandohen ndryshime.

Neni 3, pika 1: *“Akt administrativ”, është fatura e taksës së pasurisë ...”* **Koment:** se pari, fatura nuk mund të jete akt administrativ. Duhet riformuluar. Fatura tregon vetem shumën për t'u paguar, ndërsa akti administrativ duhet të përmbajë bazën ligjore, arsyet mbi të cilat mbështetet dhe pjesën urdheruese. Përndryshe, subjekti nuk mund të marrë informacione dhe mbi çfarë baze duhet të paguajë një detyrim. Nga ana tjetër, njoftimi për pagesën e taksës së pasurisë nuk mund të jete faturë pasi krijon konfuzion me legjislacionin për faturat dhe faturat elektronike, përveçse nëse bashkë do të leshojnë faturën në formë elektronike nëpërmjet sistemit të fiskalizimit.

Në ligjin për Procedurat Tatimore kemi përdorur njoftim vlerësimit, i cili duke qenë se është i aplikueshëm edhe për taksat vendore ka logjikë që të përdoret si term edhe në këtë projektligj.

Gjithashtu gjykojmë se ky perkufizim nuk është i saktë sepse referon tek një akt specifik që është fatura që përmban taksën e pasurisë dhe me pas i referohet të gjitha akteve të tjera administrative që leshohen. Pra, nga pikëpamja e teknikës legjislative, ose do të përmenden me rrjedhë specifikisht cilat janë këto akte ose do t'i referohemi në mënyrë të përgjithshme cdo akti administrativ që nxjerr kjo drejtori.

Kujtojmë se akti administrativ është një koncept i shtjelluar në Kodin e Procedurave Administrative, i cili prevalon edhe mbi ligjin për taksat vendore dhe duke qenë se kuptimi i aktit administrativ është shumë i gjërë (dhe përfshin edhe akte jo të nxjerra me shkrim nga administrata publike), do të sugjerohet që të mos perkufizohet akti administrativ në këtë projektligj, duke qenë se cdo perkufizim i tillë do të krijonte me shumë konfuzion sesa qartësi.

Neni 3, pika 2: Koment. Perkufizimi i “Autoritet publik” përfshin shoqëritë tregtare ku shteti zotëron shumicën e aksioneve. Se pari, shoqëritë tregtare ku shteti zotëron aksione në asnjë ligj tjetër nuk barazohen me autoritetin publik, për faktin se ato dalin në treg si shoqëri tregtare si të gjitha shoqëritë e tjera, për të cilat nuk ka rëndësi kush është pronari.

Neni 3, pika 4: Koment: Perkufizimi i bashkëpronesisë është i përcaktuar në Kodin Civil. Mjafton referenca në kod.

Neni 3, pika 5: Koment: Nëse cmimi referues përcaktohet në një akt tjetër ligjor apo në ligjor mjafton të bëhet referencë specifike në atë akt apo të përcaktohet akti/organi që e miraton aktin që përcakton këtë cmim referues.

Neni 3, pika 6: Koment: Në këtë pikë nuk kuptohet se për cilat lloje detyrimesh tatimore bëhet fjala. Duhet specifikuar në lidhje me taksën që vendos ky ligj.

Neni 3, pika 7: Koment: Detyrime tatimore është një nocion që rrjedh nga Ligji për Procedurat Tatimore dhe nuk e gjykojmë të nevojshme të çështet edhe këtu. Si debitori/tatimpaguesi ashtu edhe detyrimet tatimore duhen hequr si perkufizime pasi janë përcaktuar në Ligjin për Procedurat Tatimore.





Neni 3, pika 10: Koment: Specifikimi I dhene per termin “faktor vlere” nuk thote asgje ose nuk e sqaron se cfare nenkupton. Cilat do te jene faktoret e vleres? Cili autoritet do t’i vendose?

Neni 3,pika 11: Koment: Si me siper, duhet perdorur termi "njofitim vleresimi".

Neni 3,pika 12. Perse ka nevoje te shtohet termi individ. Ne legjislacionin shqiptar (Kodi Civil) ky njihet si “person fizik”. **Neni 3,pika 14: Koment:** Kategori prone te cilat percaktohen ku dhe nga kush?

Neni 3,pika 15: Koment: per kete pike gjykojme se duhet ti referohemi nocionit te mesiperm ("te njejtat kategori prone")? Kjo per te mos shtuar me teper konfuzion ne lexim. Gjithashtu duam te theksojme se ne kete pike nuk eshte e qarte cfare nenkuptohet me "vlere te vleresuar". Perkufizimi I ketij termi nuk ndihmon te kuptosh qarte "kategorine e vleres". Mos ndoshta i referohemi bazes se taksueshme? Nese po, pse mos te perdorim terminologjine ekzistuese e cila eshte gjeresisht e perdorur dhe pranuar nga institucionet, tatimpaguesit dhe profesionistet.

Neni 3, pika 17: Koment: “Ndërtëse e papërfunduar”, është një njësi ndërtëse me ose pa leje ndërtimi, që nuk ka përfunduar. **Koment:** Ky përkufizim duhet të plotësohet, në mënyrë që të jetë më i qartë, ose t’i bëjë referencë një baze ligjore sqaruese. Me rëndësi këtu është të kuptohet se kur një njësi ndërtëse quhet e papërfunduar (në cilën fazë të procesit të ndërtimit). A futet ne kete kategori nje ndertim qe ka vetem themele? Ose ajo qe eshte ne fazen karabina?

Neni 3, pika 20,21 dhe 22: Koment: Pse duhet te kemi te gjitha keto perkufizime (perfshire ketu individin) persa kohe mund ti referohemi nocionit te tatimpaguesit sipas Ligjit per proceduren tatimore.

Neni 3, pika 23: “Posedues”, është personi i cili nuk është pronari ose zhvilluesi i pasurisë së paluajtshme, por ushtron pushtetin faktik mbi pasurinë e paluajtshme, për të cilën ai nuk ka dokument pronësie ose leje ndërtimi, dhe e shfrytëzon, mban ose zhvillon atë, duke vepruar apo duke u sjellë si të ishte pronari ose zhvilluesi i saj” **Koment:** Eshte shume e rendesishme qe ne kete pike te theksohet se me kete perkufizim duket sikur perfshihen dhe ata qe e marrin pa te drejte pronen ose e uzurpojne. Ne kete menyre eshte risku shume i larte qe te legjitimohet legalizimi i godinave ne proces dhe hapjen e ketij procesi ne te ardhmen. Cka do te thote qe te legjitimohet "uzurpimi", pra te mund te konsiderohet nje veprim i toleruar ne te ardhmen, persa kohe Autoritet e Kontrollit te Territorit nuk e ushtrojne apo nuk munden te ushtrojne ne menyre sheteruese funksionet e tyre.

Gjithashtu ketu duhen sqaruar edhe të drejtat reale, sipas parashikimeve te Kodit Civil, në mënyrë që të perfshihen nga ky përkufizim të gjitha rastet, ose ato më të zakonshmet (p.sh. Uzufuktari).

Neni 3, pika 25: Koment: Serish edhe ketu ne perkufizimet e termave duhet te ishin marre parasysh percaktimet e Kodit Civil.

Duket sikur per kete ligj, ka vetem ndertesa dhe toke (bujqesore apo truall). A jane subjekt i ligjit struktura te tilla si digat, struktura e betonit e nje antene ose shtylle elektrike? Veprat industriale mund te jene te shumellojshme. Ketu ka vend per te perkufizuar ndertesen si nje objekt me tre permasa dhe i cili perdoret per t’u strehuar ose per aktivitet.

Neni 3, pika 26: Koment: Cila eshte arsyeja e nje perkufizimi te vecante per “Pronë bujqësore – blegtorale”, kur vetem qellimi i perdorimit te saj ndryshon?





Neni 3, pika 27: *“Pronë fetare”, është çdo pasuri e paluajtshme....”* **Koment:** Perkufizimi është konfuz. Prona fetare mund të përfshijë të gjithë sferën e pasurive të paluajtshme të zotëruara nga bashkësitë fetare. Një komponent / kategori e të cilave mund të jenë objektet publike të dedikuara për kryerjen e ceremonive fetare dhe ushtrimin e besimit. Duket sikur perkufizimi (rrjedhimisht përjashtimi në nenin 11) targeton vetëm këto komponente. Nëse po duhet të riformulohet. Për më tepër në këto pike gjykojmë se nuk duhet të ketë specifikime të objekteve të kultit (xhamitë, kishat, teqetë). Ose duhet të përmenden të gjitha ose të lihet vetëm përcaktimi i përgjithshëm.

Neni 3, pika 28: Koment: Perkufizimi duhet të jetë: *“Pronë industriale”, është çdo pasuri e paluajtshme, që shfrytëzohet apo është planifikuar të shfrytëzohet për veprimtari industriale dhe prodhuese ...”*

Cila është prona subjekt i këtij ligji në aktivitetin e nxjerrjes së mineraleve? Kuptohet që ndertesat që janë mbi tokë, futen tek ndertesat. Parcela është e qartë. Mos synohet të taten me takse mbi ndertesën e galeritë e minierave nëntokë? Po tek nxjerrja e zhavorrit, gurit, pse janë specifikuar nderkohe që nuk kanë asnjë vecanti në krahasim me insutritë e tjera?

Po rasti i digave të hidrocentraleve? Po centralët fotovoltaikë janë ndertese apo parcele? Sugjerojmë të jepet sqarim në ligj nëse diga është një ndertese apo parcele, në mënyrë që të mos vazhdojë abuzimi nga bashkëtitë.

Neni 3, pika 30: *“Prone rezidenciale....”* **Koment:** sugjerojmë të shtohet që përdoret për banim dhe jo për aktivitet tregtar.

Neni 3, pika 32: *“Pronë tregtare, është çdo pasuri e paluajtshme, që shfrytëzohet apo është planifikuar të shfrytëzohet për qëllime biznesi....”* **Koment:** Po në rastin kur një shoqëri real estate operon në treg dhe gjeneron të ardhura nga qiradhënia, duket sikur prona po shfrytëzohet për qëllime biznesi? Sugjerojmë të bëhet dallimi me nenin 3, pikën 30.

Gjithashtu, një problem që duket se ky ligj synon të luftojë është edhe përdorimi i ambienteve për banim (hapësira rezidenciale) për kryerjen e aktivitetit tregtar (sidomos rastet e profesioneve të lira, mesimdhënie në kurse private, dentistë, juristë, etj). Në raste të shfrytëzimit të një hapësire ndërtese për aktivitet tregtar (klinika mjekësore, qendra edukimi, call center, etj) duhet të ketë inspektim në terren dhe mirëpërcaktim të shkallës së taksës, për të shmangur abuzimet.

Pra duam të theksojmë se termi *“Per qëllime biznesi”* është gjithëpërfshirëse dhe konfuzuese në të njëjtën kohë. Për qëllime biznesi përdoren edhe godinat me funksione administrative (të dedikuara për zyra) dhe të tilla ka shumë në Tiranë. Kjo kategori nuk është aspak e kapur nga perkufizimet dhe trajtimi i p/ligjit. Prona Tregtare duhet të targetojë pasuritë e paluajtshme të dedikuara për tregtimin e mallarave me shumicë dhe pakicë (ato që rëndom njihen si dyqane apo qendra tregtare) dhe ofrimin e shërbimeve ndaj publikut (si psh deget e bankave) dhe ambientet e tyre ndihmese (si psh magazinat dhe parkimet).

Neni 3, pika 35. *“Vit tatimor....”* **Koment:** Në Ligjin për Procedurat Tatimore e kemi të perkufizuar si *“Periudhe Tatimore”*. Edhe shprehja *“kur vendoset taksa”* duhet zëvendësuar me shprehjen *“gjate të cilit aplikohet taksa”*.

Neni 3, pika 36. Koment: Të riformulohet perkufizimi dhe të vendoset emërtimi *“Baza e tatueshme”* është vlera mbi të cilën përlogaritet taksa.

Neni 3, pika 37 dhe 38. Koment: Të riformulohen sepse duket si lojë fjalesh ku *“Vlera e vlerësuar”* është vlera e tregut dhe nga ana tjetër vlera e tregut është shuma e vlerësuar?





Neni 5. Koment: Edhe ne kete pike duhet sqaruar: Kush dhe si behen matjet perkatese ne nje rast te tille?

Neni 7, pika 1: Koment: Gjate gjithë projektligjit kemi te permendur terma si baza e takses / vlera e taksueshme / vlere e vleresuar / vlere e tregut. Duhet medoemos te mbajme dy nocione baze:

(i) baza e taksueshme ; (ii) vlere e tregut sipas percaktimit te kryer nga Autoriteti.

Cdo teminologji e ndryshme apo perkufizim i panevojshme e ben te pakuptueshme dispoziten.

Neni 7, pika 2. Koment: Nese nuk sqarohen perkufizimet e termave keto klauzola mbeten te pakuptueshme.

Neni 7, pika 5: Koment: “Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë” Ku perkufizohet ky organ? Varesia dhe kompetencat?

Neni 8, pika 2: Koment: Si legjitimohet bashke-poseduesi qe te paguaje apo ti faturohet dhe atij kjo takse? Me cfare akti?

Neni 9, pika 3. Koment: Ceshtja qe ngrihet ne kete rast eshte: Si identifikohet ky taksapagues nese nuk figuron me dokument pronesie l tille? Kujt ja dergon faturen drejtoria? **Vertet qe ky percaktim mund te mos jape te drejta pronesie por vete fakti qe konsiderohet taksapagues dhe ai silltet si i tille mund te jete prove qe ai me vone ta fitoje pronen me parashkrim fitues.**

Neni 9, pika 4: “Nëse njësia e ndërtesës nuk ka përfunduar.....” Koment: Duke iu referuar këtu edhe nenit 10, pika 1.c, të sqarohet në ligj se kur ndërtesa quhet e përfunduar (ose e papërfunduar), si dhe kur lind për herë të parë detyrimi i pagesës së taksës (duke konsideruar raste të ndërtesave të papërfunduara, ose të ndërtuara por të pashfrytëzuara asnjëherë).

Godinat e pajisura me leje ndertimi te cilat jane ne ndertim e siper, jane ne procedura kolaudimi apo jane ne procedura te regjistrimit fillestar nuk mund te konsiderohen ende subjekt i kesaj takse pasi ndertesat nuk jane ende te autorizuar per perdorim (leja e perdorimit jepet nga bashkia pas inspektimit te ndertimit) dhe rrjedhimimisht zhvilluesi gjate ketyre proceseve nuk mund te konsiderohet tatimpagues per efekt te aplikimit te takses se nderteses.

Neni 9, pika 5. Koment: Ky Nen krijon nje keqkuptim te madh duke perdorur termin pronar. E formuluar keshtu mund te lere vend per interpretim duke shtrire pergjegjesine per pagesen e tatimit mbi godinen e paperfunduar tek pronari i truallit, i cili nuk ka asnje kontroll mbi procesin e ndertimit. Madje eshte i demtuari i pare nese ky proces nuk perfundon ne kohe dhe me sukses. Si dhe me siper, persa kohe godina nuk ka perfunduar procesin e regjistrimit dhe persa kohe afatet e lejes per ndertimin e saj jane respektuar, zhvilluesi nuk duhet te jete subjekt takse.

Per me teper, si mund te detyrohet te paguaje **taksen personi qe eshte pronar ne daten 30 nentor per vitin ne vazhdim?** Ky person mund ta shese pronen ne dhjetor dhe per viin vijues, pronari i ri duhet te paguaje taksen. Ligji ekzistues e ka rregulluar kete ceshtje duke u shprehur per proporcionalitetin ne kohe gjate vitit.

Edhe tek neni 10/1/c nocioni i takses ngeg tek pronesia ne date 30 nentor, nderkohe qe cfare ndodh gjate vitit nuk merret parasysh. Ndertesat e paperfunduara duhet te futen ne grupin e objekteve te tatueshme vetem me mbarimin e ndertimit ose nese konstatohet se ato banohen efektivisht/perdoren per tregti. Si mund te tatohet nje ndertese e paperfundur kur ajo nuk ka furnizim me uje dhe energji?

Neni 9, pika 6: Koment: Edhe ne kete rast e gjykojme te veshtire zbatimin ne praktike te kesaj pike apo sesi do te identifikohet nga drejtoria secili nga keto subjekte apo pjeset e tyre





perkatese? Gjithashtu ne fjaline *“Taksapaguesit janë individualisht përgjegjës për pagesën e detyrimeve tatimore”* sugjerojme qe te keni kujdes me terminologjine, sepse sipas Ligjit per Procedurat tatimore kemi termin **“Tatimpagues”**

Neni 10, pika 1/a *“Pronat shtetërore”*. **Koment:** Termi *“Prone”* nuk eshte i duhuri. Prona perfshin sendet e luajtshme dhe te paluajtshme qe bien ne sferen e pronesise se nje personi. Ne rastin konkret ligji ka per objekt pasurite e paluajtshme. Rrjedhimisht duhet te perdoret minimalisht termi *“Pasuri”* ose *“Pasuri e Paluajtshme”* sidomos kur i referohemi llojit apo kategorimve te tyre per efekt perjashtimi apo aplikimi takse.

Neni 10, pika 1/c *“Ndërtesat e papërfunduara, që në 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor, janë duke u ndërtuar në përputhje dhe brenda afatit të ndërtimit të përcaktuar në lejen e ndërtimit”* **Koment:** Do te kete nje afat per kete perjashtim apo eshte i perjetshem? Dhe per termin ndertuar sugjerojme qe te mos jete vetem ndertuar, sepse ato mund te jene ne proces koladimi dhe ne proces regjistrimi fillestar.

Neni 10, pika 1/e: **Koment:** Të konsiderohet shtimi në fund të kësaj pike, edhe *“personat që janë të papunë, sipas përcaktimit ligjor të personit të papunësuar”*.

Neni 10, pika 3: *“...kategori të tjera të vlerave dhe pronave...”* **Koment:** Pse vlerash? A jane pasuri te perjashtuara nga tatimi?

Neni 11. Koment: Duhet te harmonizohen dhe te unifikohen termat e perdorur, te cilat mbartin nje llogjike juridike dhe semantike qe i referohet nje tradite qe duhet respektuar.

Neni 12, pika 2. Koment: Në vijim të komenteve më lart, duhet sqaruar se në cfare faze të procesit të ndërtimit ndertesa quhet *“ndërtesë e papërfunduar”*. Cili është momenti kur lind taksa për këtë ndërtesë? **Ka dallim dhe duhet bere dallimi midis objekteve/ godinave ne ndertim e siper te cilat jane brenda Lejes se Ndertimit apo ne proces koladimi ose regjistrimi fillestar dhe objekteve/ godinave ndertimi i te cilave eshte i paperfunduar dhe afatet e Lejes se Ndertimit kane perfunduar prej mese paku 2 vitesh. Ne te kundert eshte abuzive dhe ne shkelje kushtetuese taksimi i nje prone qe ende nuk ekziston sipas te gjitha kritereve ligjore per njohjen e ekzistences se saj.**

Neni 13, pika 5: Koment: Kjo dispozite le vend per interpretime arbitrare. Bashkia nuk percakton Tatimpaguesit. Tatimpaguesi identifikohet automatikisht sipas kritereve te percaktuara ne kete Ligj. Gjithashtu duhet patur kujdes me terminologjine. Jo *“taksapagues”* po *“Tatimpagues”* sipas Ligjit per Procedurat Tatimore.

Neni 13, pika 7 dhe 9. Koment: Nuk kemi nje *“fature”* kemi nje *“njoftim vleresimi”* sipas Ligjit per procedurat tatimore.

Neni 13, pika 11 dhe 13. Koment: Tatimpaguesi eshte subjekti i legjitimuar qe perfaqeson dhe mban te gjithe sferen e interesave qe rregulluara nga ky ligj. Vetem tatimpaguesi eshte dhe duhet te jete kreditor, debitor dhe person i interesuar ne kuptim te ketij ligji. Ai mund te veproje individualisht ose nepermjet perfaqesuesve. **Ne kete llogjike cilesimet si *“debitor”* apo *“person i interesuar”* jane, nga njera ane, te panevojshme dhe, nga ana tjeter, mund te lene vend per interpretimi (si ne rastin e personit te legjitimuar).**

Neni 14, pika 1. Koment: Ajo c'ka ka interes ne kuptim te ketij ligji jane funksionet e institucionit. Funksionet shtetërore ne kuptim te Kodit per Procedurat Administrative ushtrohen nga Organi Publik.

Neni 15. Kadastra fiskale: Nepermjet kesaj klauzole presupozohet qe te kete nje dublikim regjistrash publike.





Neni 15, pika 1 Neni 15 është krejt i përgjithshëm dhe paragrafi 1 është konfuz. Kadastra Fiskale institucionalizohet (krijohet me këto ligj). Rrjedhimisht funksionalitet e saj (si një sistem menaxhimi informacioni) duhet të jenë të mirëpërcaktuara nga ky ligj. Ndërsa detajet specifike të ndërtimit, regjistrimit të informacionit dhe administrimit të saj mund të rregullohen nëpërmjet një VKM-je.

Neni 15, pika 2. Koment: Duhet të referohet që përgjegjësinë për krijimin, mbajtjen dhe perditesimin e të dhënave në Kadastres Fiskale e ka Bashkia. Në të kundërt, nëni flet për një instrument me funksionalitete të pa përcaktuar (i tillë është prg 1) dhe përgjegjësi administrimi të papërcaktuar.

Neni 16, pika 1. Koment: Kadastra Fiskale krijohet dhe menaxhohet nga Bashkita. Cili është roli i DPTP në shkëmbimin e informacionit me ASHK në këto kontekste? Gjithashtu kjo pikë ka përplasje me Ligjin 111 "Për Kadastren".

Neni 17, pika 1: Koment: Bashkia mund të bëjë këto verifikime nëse të dhënat për pasurinë (të cilat çojnë në përcaktimin e bazës së taksueshme) mungojnë ose janë dukshëm në kundërshtim me gjendjen e saj të faktit. **Sic është shkruar dispozita krijon hapësirë për zbatim arbitrar në praktike.**

Neni 17, pika 2 dhe 3: Koment: Te tilla verifikime kryhen para regjistrimit të pronës në regjistrat kadastrale. Në gjykimin tonë Bashkia nuk duhet të ketë një kompetencë të tillë.

Gjithashtu në pjesën "*Bashkia mund të kontraktojë operatorë privatë , për të asistuar Strukturën e Taksave Vendore.....*" **Koment:** Me operatorë private do të kuptojmë entitete, apo edhe persona fizikë, sipas perkufizimeve të ligjit të ri të tatimit mbi të ardhurat (Ligji nr. 29/2023)? Duhet sqaruar në ligj që koston e operatoreve private e mban bashkia dhe jo tatimpaguesi.

Neni 18. Koment: Cila është frekuenca me të cilën do të kryhet vlerësimi i pasurive? **Neni nuk jep në mënyrë transparente dhe të strukturuar kriteret udhëheqëse të këtij procesi.**

Neni 18,pika 1. Koment: Duket se mungon në ligj përcaktimi se vlerësimi i një pasurie është vjetor, dhe bëhet vetëm një herë në vit, dhe nënkupton se taksa e pasurisë e përcaktuar për një vit, nuk mund të ndryshojë më (brenda vitit fiskal), si rezultat i ndryshimit të vlerës referuese. Çdo vlerësimi i ri duhet të fillojë zbatimin për vitin e ardhshëm fiskal. Gjithashtu lind pyetja: A duhet të merret ky informacion në konsideratë nga DPTP në përcaktimin e bazës së taksueshme? Nuk është e qartë lidhja midis paragrafit 1 dhe 2.

Gjykojmë se në parim këto vlerësime duhet të bëjë ASHK që mban edhe regjistrat e pasurive. Kjo është edhe funksionalisht një shërbim që ASHK e ka me të thjeshtë ta ofrojë. Sa parashikohet në këto nën është një fryrje e pavlerë e procedurave.

Neni 18, pika 3. "bashkëpunojnë dhe mund të themelojnë komisione të përbashkëta për vlerësimin e pasurive të paluajtshme...." **Koment:** Për përpilimin e projektakteve. Funksionin vlerësues në kuptim të këtij Ligji e ushtron DPTP. Pra nëse bëhet fjale për grupe pune me funksione konsultative paragrafi duhet riformuluar.

Neni 18,pika 4. "Drejtorja e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës mund të kontraktojnë vlerësues privatë të licencuar të pasurive të paluajtshme ..." **Koment:** Në gjykimin tonë, vlerësues privatë të licencuar janë individë, të cilët kanë përfunduar një cikël studimi të certifikuar (duke përmblusur kushtet e nevojshme paraprake) për vlerësimin e pasurive të paluajtshme. E paqartë nëse në rastet e entitetesh që kanë të punësuar këta individë, do të mund të përdoret licenca e tyre mbi këtë veprimtari. Në cilat raste kontraktohet vlerësuesit privatë? Çfarë përpalesie ka vlerësimi i kryer prej tyre në raport me vlerësimin e kryer nga ASHK?





Neni 19. Koment: Sipas ligjit per procedurat tatimore nuk kemi fature takse. Kemi vleresim tatimor i cili i njoftohet Tatimpaguesit. Gjithashtu duhet sqaruar nese ky eshte Detyrim apo Akt Administrativ.

Neni 19, pika 3. Koment: Kjo nenkupton qe detyrimi deri ne 1000 leke nuk konsiderohet detyrim tatimor. Te riformulohet pika ose te hiqet si pike. Kjo percaktohet ne ligjin per procedurat tatimore

Neni 19, pika 4. Koment: Detajet mbi dërgesën e faturës dhe marrjen/venien në dijeni të taksapaguesit mund ti gjejmë në nenin 29 më poshtë. **Por me shumë rëndësi është të sigurohet që cdo faturë apo balancë e detyrimit të shfaqet në e-Albania në kohë reale. Kjo çështje bëhet shumë e rëndësishme në situatat kur tatimpaguesi nuk është dakord me detyrimet e përlllogaritura, dhe dëshiron të paraqesë ankimim sipas procedurës ligjore.**

Gjithashtu sugjerojme qe ne vend te termit “dërgon” te vendoset termi “njofton”. Duhet sqaruar dhe menyra se si do te behet njoftim dhe ku do te behet. **Sipas nenit 32 te Ligjit per Procedurat Tatimore tatim paguesi ka të drejtë të marrë njoftim për çdo akt administrativ, veprim ose mosveprim, të bërë për mbledhjen e detyrimeve tatimore, i cili prek pasurinë e tij.**

Neni 19, pika 5. Koment: Pavaresisht se ne nenin 30 eshte percaktuar se cili do konsiderohet momenti I marrjes ne dorezim, mendoj qe ketu duhet percaktuar se kur nis ky afati 45 dite kalendardike.

Neni 19, pika 6. Koment: Cfare vlere ka ky publikim? **Sipas Ligjit per Procedurat Tatimore dhe sipas paragrafit 4 mesiper njoftimi duhet te jete individual?**

Gjithashtu ketu duhen sqaruar rrethanat se si do te njoftohet individi? Me shkrese ne adresen e tij duke qene se aktualisht kjo procedure nuk ndiqet nga Bashkia dhe individet nuk informohen apo nuk e marrin njoftimin.

Neni 19, pika 7. Koment: Duhet sqaruar se ne cilin prej mjediseve te Bashkise? Bashkia ka shume ambiente dhe nese nuk publikohet, sic edhe mund te ndodh?

Neni 20, pika 1. Koment: duhet riformuluar. Gjoha eshte gjobe per mospagese te detyrimeve te meparshme, nuk mund te lihet te paguhet me dy keste, sic paguhet taksa ne vitin ne vijim.

Neni 20, pika 2. Koment: Ne gjykimin tone, kjo dispozite eshte antikushtetuese pasi te vendos nje detyrim pa patur mundesi te provosh qe nuk e ke marre njoftimin? Ne cilin parim mbeshtet ky absolutizem?

Neni 21. pse nuk i behet reference nenit te kamatevoneses tek ligji i procedurave por perdoren terminologji te dobeta si “norma e vendosur nga DPT”.

Neni 22. Koment: Sugjerojme qe te behet njehere njoftim paraprak dhe duke i lene nje afat per plotesim fillimisht.

Gjithashtu Pezullimi i sherbimeve targeton individet me te dobet ekonomikisht dhe jo tatimpaguesit relevant. C'ka ne praktike prodhon efekte e nje trajtimi te pabarabarte.

Sipas nenit 89 te Ligjit per Procedurat Tatimore:

"1. Kur administrata tatimore konstaton se një tatimpagues nuk ka paguar plotësisht dhe në datën e caktuar detyrimet tatimore, **ajo i dërgon atij, me postë rekomande ose në rrugë elektronike, një njoftim me shkrim, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimit tatimor. Për**





njoftimin dhe kërkesën për të paguar detyrimet tatimore zbatohen afatet dhe procedurat e parashikuara në nenin 69 të këtij ligji.

2. Nëse tatimpaguesi nuk përdor të drejtën e ankimit dhe nuk paguan detyrimin tatimor, administrata tatimore duhet ta mbledhë **tatimin, duke përdorur njërin ose disa prej mënyrave, të parashikuara në këtë kre**".

Persa me sipër konstatohet se (i) pezullimi i shërbimeve nuk është një nga format shtrenguese të mbledhjes të parashikuara nga Kreu XI i Ligjit për Procedurat Tatimore dhe se (ii) mbledhja e detyrimit me forcë kushtezohet nga dhenia e një njoftimi paraprak. **KREU VII Mjetet Ligjore: Dispozitat e këtij Keu duhet të jenë në përputhje me parashikimet e Ligjit për Procedurat Tatimore**

Se fundmi, masat shtrenguese duhet të jenë proporcionale me shkeljen e kryer. Përcaktimi i llojit të shërbimit nga cdo bashki do të krijojë situata ekstreme duke patur parasysh nivelin jo të duhur të stafit të tyre.

Neni 24 dhe neni 25 duhet të fshihen dhe të behet reference tek procedurat tatimore, të cilat janë implementuar për shumë vite dhe janë qartësuar. Nuk ka nevojë për shpikje procedurash të reja.

Neni 24, pika 2. *"...në Bashkinë që ka gjeneruar faturën, jo më vonë se data 30 prill e atij viti tatimor"*

Koment: Me rëndësi është fakti se afati i ankimit duhet të lidhet gjithashtu edhe me datën në të cilën personi është vënë në dijeni (ose duhet të ishte vënë në dijeni) të detyrimeve mbi taksën.

Ankimi administrativ ka afate të tjera sipas kodit të procedurave administrative, cili do të prevalojë? Kodi, në rangun e akteve normative, ka fuqi më të lartë.

Neni 24, pika 6. Koment: Në kete pikë duket sikur ka hapësira që të lindë një konflikt interesi, pasi i njëjti institucion i cili vendos detyrimin, shqyrton më pas edhe ankimitin ndaj këtij detyrimi. Rrjedhimisht, do të sugjerohet si zgjidhje më të përshtatshme të paraqitet ankimi në Drejtorinë e Apelit Tatimor, sipas ligjit për procedurat tatimore, për të garantuar një procedurë më të sigurt shqyrtimi në këtë hallkë.

Neni 24, pika 10. Koment: Në gjykimin tonë, kjo pikë do të ishte më e plotë nëse përcakton edhe afatin se kur duhet të dërgohet kërkesë-padia në gjykatë.

Zakonisht mosdhenia e përgjigjes konsiderohet pranimit ankimit dhe nëse personi shkon në gjykatë pa pasur asnjë përgjigje, mendoj që mund të konsiderohet që nuk ka ezauruar hapat e ankimit administrativ dhe gjykata nuk do të dijë se cilin vendim të interpretojë apo të gjykojë. Pra, duket sikur llihet hapësirë individit të ankohet por në fakt krijon problematika për të apo ngerce që ngelen varur nëpër gjykata. Nuk jemi dakord me kete pikë.

Neni 24, pika 11. Koment: Pse duhet të kete modele tip ankimi?

KREU VIII Sanksionet: Dispozitat e këtij Kreu duhet të jenë në përputhje me parashikimet e Ligjit për Procedurat Tatimore.

Gjobat duhet të jenë sic aplikohen për tatimet e tjera për cdo ditë vonese në mënyrë që sanksioni të jetë proporcional me demin që i vjen bashkisë.

Nuk e kuptojmë pse duhen shpikur sanksione të tjera kur kemi një strukturë që aplikohet.





Neni 26, pika 3 dhe pika 4. Koment: Keto dy pika (Pikat 3 dhe 4) vendosin dy gjoba të ndryshme; mbetet e paqartë se cili është qëllimi i tyre, duke qenë se një gjobë e caktuar sipas ligjit për procedurat tatimore është konsistente dhe me gjobat e tjera për mospagesën në kohë të tatimeve. Duhet sqaruar kjo pikë, pasi duket se penalizon më tepër në % debitorin se sa taksapaguesin që nuk paguan në kohë, nëse ky është qëllimi i saj.

Neni 27. Koment: Ky nen duhet të jete në përputhje me parashikimet erkates të Ligjit për Procedurat Tatimore.

Neni 27, pika 1. Koment: Konstatojme që kjo klauzole është pa kuptim. Gjithashtu lind pyetja nëse nuk ka detyrime të papaguara çfarë ndodh?

Neni 28, pika 1/b. Koment: Publikimi i kontratave të shitblerjes dhe të dhenave që ato përmbajnë është në shkelje të ligjit për Procedurat Tatimore dhe Ligjit për të dhenat Personale. Jo me kot regjistri/at e ASHK janë të aksesueshme vetëm nga personat e legjitimuar për të marrë informacionin nga to. Si psh pronari dhe organet ligjzbatuese.

Te dhenat në lidhje me një pasuri të caktuar nuk janë të dhena publike. Si të tilla nuk mund të publikohen apo të aksesohen nga publiku. Aq më pak janë publike të dhenat e transaksioneve me pronat si kontrata e shitblerjes.

Neni 29, pika 1/c Koment: Duhet rishikohet sipas KPA. Sipas nenit 156 të Kodit të Procedurës Administrative:

1. Njoftimi nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik apo me faks bëhet kur marrësi ka rënë paraprakisht dakord për këtë mënyrë njoftimi **dhe nëse ligji nuk parashikon një formë tjetër të detyrueshme njoftimi**. Nëse njoftimi është i palexueshëm, marrësi mund t'i kërkojë organit publik ta ridërgojë njoftimin në një formë tjetër më të përshtatshme.

Neni 29, pika 3. Koment: Duhet rishikohet sipas KPA. Sipas nenit 156 të Kodit të Procedurës Administrative:

2. Një shkresë, dërguar me mjete të komunikimit elektronik, vlerësohet e marrë në përputhje me parashikimet e ligjit për komunikim elektronik.
3. Një shkresë e dërguar me faks vlerësohet e njoftuar në ditën e tretë nga data e dërgimit.
4. Pikat 2 dhe 3, të këtij neni, nuk zbatohen nëse marrësi provon se shkresa nuk është marrë, apo është marrë në një datë të mëvonshme.

Neni 29, pika 4. Koment: Ky opsion mund të le vend për interpretim dhe abuzim. Njoftimi i vleresimit tatimor mund të kryhet në accountin e Tatimpaguesit në e-Albania dhe të mbështet në parashikimin e mëposhtëm të Kodit për Procedurat Administrative:

Neni 161

Njoftimi nëpërmjet publikimit elektronik

3. Njoftimi i një dokumenti elektronik mund të bëhet edhe nëpërmjet shkarkimit nga një server i caktuar, i mbyllur për publikun, vetëm nëse palës i sigurohet, paraprakisht, akses nëpërmjet mjeteve elektronike autentike të identifikimit, dhe nëse ajo është vënë në dijeni me një njoftim paraprak për datën, apo periudhën e saktë kur dokumenti mund të shkarkohet.





4. Njoftimi, sipas pikës 3, të këtij neni, vlerësohet si i bërë në datën e shkarkimit të tij nga serveri. Nëse shkresa nuk është shkarkuar në datën e përcaktuar, organi publik i dërgon palës një njoftim të dytë. Nëse shkresa nuk është shkarkuar në datën e caktuar në njoftimin e dytë, ajo njoftohet në një mënyrë tjetër të përshtatshme

Neni 31. Koment: Ky ligj ka përparësi për ato që nuk trajtohen nga Ligji I Procedurave Tatimore. Për aspektet e tjera ky ligj duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurat Tatimore që vendosin në mënyrë të përgjithshme dhe detyruese rregullat dhe parimet e vendosjes së tatimit gjobave e kamatvonesave, njoftimit, ankimit dhe mbledhjes jo vullnetare të taksave

Neni 32. Koment: Cili do të konsiderohet viti i vendosjes së taksës së pasurisë?

Neni 33. Koment: Mund të ketë shumë raste kur një pasuri e paluajtshme është objekt konflikti mes 2 apo më shumë palëve. Si e ka vlerësuar ligjvënësi ta zgjidhë këtë rast?

Neni 35. Koment: Poseduesi duhet të jetë i përjashtuar në cdo rast. Në parim ky Projektligj parashikon taksën e Pronës.

Neni 36, pika 2/a dhe b. Koment: Sic është theksuar edhe më sipër, si do të klasifikohet një njësi ndërtese, apartament i dhënë me qera për banim nga një pronar individ, si ndërtesë për banim, apo për veprimtari ekonomike?

Neni 36, pika 6. Koment: Nga Këshilli i Ministrave jo institucionet e varësisë dhe strukturat organizative të Këshillit të Ministrave.

Neni 36, pika 8. Koment: Kush konsiderohet Agjent tatimor? Është organ publik apo privat? Cilat janë kriteret për të emëruar një të tillë? Po përgjegjësitë e tij?

Neni 39., pika 1. Koment: Formulimi i kësaj pike do të kërkojë edhe një ndryshim të Ligjit 111 "Për Kadastrën". Gjithashtu duhet sqaruar nëse bashkia do të ketë një dublikatë të regjistrave kadastrale?

Neni 39, pika 2. Koment: Këtu duam të theksojmë se i vetmi dokument që vërteton titullin e pronësisë është Certifikata e vërtetimit të pronësisë.

Neni 39, pika 3. Koment: Nuk mundet që një institucion vendor të ketë kompetenca mbi një organ shtetëror qendror, në këtë rast Kadastra Shtetërore.

Neni 39, pika 4. Koment: Regjistrimin apo cregjistrimin? Do të kishte kuptim të thuhej që kadastra nuk kryen veprim me një pronë nëse nuk janë paguar taksat, por jo regjistrim/cregjistrimin. Cfarë do të thotë kjo?

Duke shpresuar se kërkesat dhe sugjerimet tona të merret në konsideratë,

Me respekt,

Neritan Mullaj

Drejtor Ekzekutiv

